

VENDIM
Nr.180, datë 9.5.1992

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.379, DATË
8.9.1987 "PËR KUALIFIKIMIN SHKENCOR PASUNIVERSITAR PËR MARRJEN E
GRADAVE DHE TË TITUJVE SHKENCORË"**

Me propozimin e Komisionit të lartë të atestimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.379, datë 8.9.1987, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 11 ndryshohet si vijon:

"Mbrotjtja e disertacionit të shkallës së parë bëhet pasi të jenë dhënë provimet e parashikuara në këtë vendim. Mbrotjtja e disertacioneve për të dy shkallët është e hapur, përveç rasteve kur ato përmbajnë të dhëna që janë sekret shtetëror, dhe behet përpara jurive që ngrihen për çdo disertacion pranë shkollës së lartë, institucioneve kërkimore-shkencore dhe studimore-projektuese, të cilat në fushën përkatëse të dikasterit mbajnë peshën kryesore të kërkimit shkencor në shkallë kombëtare. Komisioni i lartë i atestimit përcakton institucionet ku do të ngrihen këto juri, mënyrën e ngritjes dhe të funksionimit të tyre.

Disertacionet e shkallës së parë, të mbrojtura në komisionet e posaçme të mbrojtjeve deri në ditën e daljes së këtij vendimi, do të miratohen nga seksionet përkatëse të komisionit të lartë të atestimit, siç është vepruar deri tani".

2. Në pikën 13 paragrafi i parë dhe shkronjt "a", "b" dhe "ç" ndryshohen si vijon:

"Në provimet pasuniversitare të shkallës së parë të kualifikimit shkencor përfshihen këto lëndë:

- a) lënda e përgjithshme e specialitetit;
- b) një ose dy lëndë të posaçme që lidhen me temën e disertacionit;
- c) të mbetet përmbajtja siç është në shkronjën "ç"

3. Pika 19 ndryshohet si vijon:

"Gradat shkencore dhe titujt shkencorë jepen si vijon:

a) Grada shkencore "Doktor i shkencave", pas mbrojtjes në juri, jepet nga seksioni përkatës i Komisionit të lartë të atestimit.

b) Grada shkencore "Kandidat i shkencave" jepet nga juria përkatëse. Dosja e kandidatit dërgohet përpara mbrojtjes në sekretarinë e Komisionit të lartë të atestimit, e cila bën verifikimin për rregullshmërinë e saj dhe lejon mbrojtjen. Diplomat firmosen nga kryetari i Komisionit të lartë të atestimit.

c) Titujt shkencorë "Docent", "Bashkëpunëtor i vjetër shkencor" dhe "Profesor" jepen nga Komisioni i lartë i atestimit.

Propozimet për titullin shkencor "Docent" i bëjnë këshillat shkencore të fakulteteve, kurse për titullin shkencor "Bashkëpunëtor i vjetër shkencor" këshillat shkencore të institucioneve kërkimore shkencore e studimore-projektuese.

Propozimin për titullin shkencor "Profesor" e bën këshilli shkencor i shkollës së lartë ose i institucionit kërkimor-shkencor e studimor projektues, mbi bazën e propozimit të këshillit shkencor të fakultetit ose të institucionit. Komisioni i lartë i atestimit përcakton listën e shkollave të larta dhe të institucioneve kërkimore shkencore e studimore-projektuese, këshillat shkencore të të cilave kanë të drejtë të paraqesin propozime për dhënien e titullit shkencor "Profesor" në Komisionin e lartë të atestimit".

4. Pas pikës 25 shtohet pika 25/a me këtë përmbajtje:

"Anëtarët e komisionit të lartë të atestimit dhe të jurive për punën që bëjnë marrin shpërblim, masën e të cilit e përcakton Komisioni i lartë i atestimit".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

